



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:266467

Datë: 21.02.2024

Numri i dokumentit: 05354678

CPP.nr.135/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit K... sh.a, me seli në Prishtinë, kundër debitorit H.K nga Vushtrria, lidhur me çështjen përmbartimore pagimi i Borxhit në shumë prej 1563,59 €, për periudhën kohore prej 23.11.2015-04.05.2022, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit, jashtë seance, me datën 21.02.2024, e mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT i bazuar prapësimi i debitorit H.K nga Vushtrria ashtu që SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri përmbartimor P.nr.804/22 i datës 21.06.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat A.M në territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, përkatësisht për shumën prej 1351,41 euro për periudhën kohore prej 23.11.2015-31.12.2020 për shkak të parashkrimit, ndërsa MBETET PJESËRISHT NË FUQI për pjesën tjetër të borxhit në shumë prej 212,18 € për periudhën kohore prej 01.01.2021-04.05.2022.

II. OBLIGOHET debitori H.K nga Vushtrria, që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, kreditorit K... sh.a, me seli në Prishtinë në emër të borxhit për energjinë elektrike të pa paguar, për periudhën kohore prej 01.01.2021-04.05.2022, t’ia paguaj shumën prej 212,18 €, me kamatë ligjor prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përmbartim, me datën 20.06.2022 e deri në pagesën definitive të borxhit.

III. Në rast ankese kundër këtij aktvendimi urdhërohet pala ankuese që konform nenit 78 par.1 të LPP-së paraprakisht të paguaj garancinë në të holla në shumë prej 212,18 € si parakusht për parashtrimin e ankesës, në të kundërtën, gjykata konform nenit 78 par.4 të LPP-së do të konsideroj se ankesa nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat A.M, në territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit të paraqitur me datën 212,18 € ka lëshuar Urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstrakteve nga librat afarist. Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit brenda afatit ligjor është ushtruar prapësim nga debitori, me të cilin e kundërshton urdhrin përmbartimor si të pabazuar. I njëjti ndër të tjera thekson se borxhi është parashkruar, sipas dispozitave të nenit 360 par 2 të LDM-së dhe kërkon nga gjykata që të aprovoi prapësimin si të bazuar dhe të anuloi urdhrin përmbartimor.

Kundër prapësimin të debitorit ka paraqitur përgjigje në prapësim kreditori në të cilin ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit. Thekson se debitori ka bërë disa pagesa të kohë paskohshme përmes të cilave ka ndërprerë afatin e parashkrimit sipas nenit 368 të LMD-së. E njëjta kërkon nga gjykata që urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi, ndërsa kundërshtimet e debitorit të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të prapësimin të ushtruar nga debitori, përgjigjes në prapësim të debitorit e në bazë të provave në shkreat e lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e debitorit se borxhi i kërkuar nga kreditori ka arritur afatin e parashkrimit, gjykata vlerëson se ky pretendim i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe atë për për shumën prej 1351,41 euro për periudhën kohore prej 23.11.2015-31.12.2020 si borxh i parashkruar, ndërsa pjesa tjetër e borxhit për periudhën kohore prej 01.01.2021-04.05.2022, në shumën prej 212,18 €, nuk është parashkruar, në pajtim me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në nenin 360 par 1 pika 1.1 të LMD-së ku përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti: kërkesat për furnizim me energji elektrike, (per nevoja shtëpiake), ndërsa par 2 përcakton se: afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin arrihen kërkesat për pagesë”*.

Gjykata me rastin e vendosjes gjeti se debitori ka bërë pagesa të kohë pas kohshme për pakësimin e borxhit por se këto pagesa nuk mund të konsiderohen këste, pasi që për tu konsideruar këst duhet të jetë i paguar saktësisht aq sa i vjen për pagesë kësti debitorit, si dhe duhet të ketë një marrëveshje paraprake në mes debitorit dhe kreditorit për pagesen e borxhit e në rastin konkret nuk qëndron një raport i tillë, në mes palëve ndërgjyqëse, andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke pas parasysh edhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.148/2012 i cili thekson se: Në rastet kur debitori paguan herë pas here një shumë paushalle, mirëpo nuk është specifikuar asnjëherë se ato pagesa me cilin muaj të shpenzimit të energjisë elektrike kanë të bëjnë, nuk mund të thuhet se është ndërprerë parashkrimi i këtij borxhi”.

Pra gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës, si dhe periudhës kohore për të cilën është propozuar dhe lejuar përmbartimi, erdhi në përfundim se borxhi i cili rrjedhë nga ekstrakti i librave afarist të kreditorit për periudhën kohore prej dt. 23.11.2015-31.12.2020 është i parashkruar dhe pa paguar për këtë periudhë kohore, ndërsa që nga data 01.01.2021-

04.05.2022 borxhi nuk është i parashkruar dhe për të njëjtin lejohet përmbarimi, ashtu siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata, lidhur me kamatën ligjore, iu referua nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Ndërsa sa i përket afatit të rrjedhjes së kamatëvonesës, gjykata i referohet mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/20 të datës 01.12.2020, respektivisht par. II, III dhe VI të këtij mendimi juridik dhe gjeti se debitori ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit nga data kur është ushtruar propozimi për përmbarim e tutje.

Nga shkaqet e theksuara më lart rezulton se Prapësimi i ushtruar nga debitori është pjesërisht në pajtim me nenin 71 par.1 pika.4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore dhe të njëjtin gjykata e aprovoi pjesërisht si të bazuar, duke zbatuar dispozitën e nenit 73 të LPP-së.

Gjyqtari
Izet Gërguri

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*